

Statistikat rajonale

Blerina Subashi


INSTAT

Hyrje

- Vjetari Statistikor Rajonal 2015 ka si qëllim:
 - Të japë një pamje të statistikave rajonale të disponueshme për vendin.
 - Të jetë një ndihmesë për të kuptuar diversitetin që ekziston midis rajoneve.
 - I përgjigjet një kërkesë në rritje për të dhëna të disagreguara në nivel rajonal, për politika dhe studimeve të fokusuara në rajone të veçanta.
- Bazohet në të dhënat e 5 viteve të fundit 2010-2014, me përjashtim të rasteve ku janë botuar të dhënat më të fundit të disponueshme.
- Është bërë pjesë e kalendarit të publikimeve për periudhat në vazhdim

- Ky publikim është konceptuar bazuar në publikimin e statistikave rajonale të Eurostatit:
 - **14 Fushave** të cilat përmban
 - Popullsia
 - Projektionet
 - Statistikat Juridike
 - Arsimi...
 - **Struktura** brenda një fushe të caktuar –Gjetje kryesore brenda secilës fushë
- Botimi mbështetet nga tabela, graf si dhe harta të cilat synojnë të lehtësojnë analizën.

Koeficienti i ndryshimit të popullsisë, mesatare 2010-2014




POPULLSIA

Vetëm qarku i **Tiranës** dhe i **Durrësit** kanë norma mesatare rritjeje pozitive të popullsisë gjatë periudhës 2010-2014 respektivisht 1,4% dhe 0,8%.


Qarku i cili regjistron rënien më të lartë të popullsisë gjatë viteve 2010-2014 është ai i **Gjirokastrës** me një rënie prej 2,7 për qind ose 2 mijë banorë çdo vit.

Lëvizjet e brendshme të popullsisë, 2014



Tirana dhe **Durrësi** vazhdojnë të jenë qarqet **top destinacion për migrantët e brendshëm.**

Indeksi sintetik i fekonditetit




Dibra dhe **Kukësi** janë qarqet me numrin më të madh të fëmijëve për një grua në moshë ripordhuese respektivisht 2.56 dhe 2.33 fëmijë për grua. Këto dy qarqe janë të vetmet qarqe me nivel lindshmërie më të lartë se norma e zëvendësimit 2.1 fëmijë për grua.

PROJEKSIONET E POPULLSISË

Në këtë modul janë përfshirë parashikimet e numrit të popullsisë sipas prefekturave për periudhën 2011-2031, sipas vlerësimeve dhe supozimeve që INSTAT ka bërë bazuar në Censurin 2011.

Gjetje kryesore

- Sipas projeksioneve popullsia për periudhën e projekuar 2011-2031 do të bjerë në total me **4%**
 - Viti 2011- 2.9 milion
 - Viti 2031- 2.78 milion.
- Qarqet e të cilat do të kenë **rritje** të popullsisë do të jenë:
 - Tirana – rritje 25%
 - Durrësi – rritje 4%
 - Vlora – rritje 3 %
- Rënia** më e shpejtë e popullsisë pritet të ndodhë në qarqet e
 - Kukësit – rënie 31%
 - Gjirokastrës - rënie 32%
 - Dibrës – rënie 34%




ARSIMI

Ky modul paraqet të dhëna dhe tregues kryesorë për arsimin para universitar në të gjitha qarqet dhe vendin.


- Treguesi mësues për nxënës në shkollat fillore publike është më i lartë në qarqet e
 - Tiranës
 - Durrësit

Nxënës për Mësues për shkollat publike dhe private për arsimin fillor, 2013-2014




- Treguesi mësues për nxënës për shkollat e mesme është më i lartë në qarqet e
 - Tiranës,
 - Durrësit
 - Kukësit.

Nxënës për mësues në arsimin e mesëm publik dhe privat, 2013-2014




ARSIMI

- Qarku i Kukësit është i vetmi qark, i cili nuk ka shkolla të mesme as private dhe as profesionale.
- Ndërkohë në qarkun e Tiranës është përqëndrimi më i madh i këtyre shkollave.
- Korça ka më shumë shkolla të mesme profesionale se private



VARFËRIA




Përqindja e të varfërve mat përqindjen e popullsisë që është e varfër. Pra popullsinë që ka të ardhurat dhe konsumin poshtë linjës së varfërisë (4891 lekë, përcaktuar nga Banka Botërore).

Hendeku i varfërisë mat masën e shtrirjes poshtë linjës së varfërisë të secilit individ si pjesë e linjës së varfërisë, pra sa larg të varfërit janë nga linja e varfërisë.

PRODUKTI BRENDSHËM BRUTO

Gjetjet kryesore për vitin 2012:


- PBB për frymë në qarqet **Tiranë**, **Fier** dhe **Durrës** tejkalojnë PPB-në për frymë mesatare në nivel vendi.
- Qarku me peshën më të lartë ndaj PBB-së për vitin 2012 ka qenë qarku **Tiranë** me një peshë prej 38,2%. Qarku me peshën më të ulët ndaj PBB-së për vitin 2012 ka qenë qarku **Kukës** me një peshë prej 2,1%.
- Qarku me rritjen ekonomike më të ulët për vitin 2012 ka qenë qarku **Gjirokastër** me -11,3%. Qarku me rritjen ekonomike më të lartë për vitin 2012 ka qenë qarku **Dibër** me 13,2%.



REGJISTRI I NDËRMARRJEVE


Fig. 1 Shpërndarja e ndërmarrjeve aktive sipas qarqeve

- Regjistrat e njësive ekonomike përmbajnë të gjitha njësitë ligjore jo bujqësore (ndërmarrjet e institucionet) që ushtrojnë aktivitet ekonomik brenda territorit të Shqipërisë.
- Në vitin 2014 kemi 9.499 ndërmarrje aktive më shumë se në vitin 2010.



REGJISTRI I NDËRMARRJEVE

Përqindja e ndërmarrjeve të reja, 2014




Në qarkun e Tiranës janë përqendruar numri më i madh i ndërmarrjeve

Numri më të vogël është përqendruar numri më i vogël Kukësit.

TURIZMI

Hyrjet e shtetasve të huaj dhe daljet e shtetasve shqiptarë sipas qarqeve, 2014




Hyrjet mesatare të shtetasve të huaj janë rritur **11,6%** dhe pjesën më të madhe e zënë **hyrjet nga toka** me 84 %. **Qarku i Kukësit** është qarku me përqindjen më të lartë me 53,3% nga ku janë regjistruar hyrjet e shtetasve të huaj.

Daljet mesatare të shtetasve shqiptarë janë rritur me **5,9 %** gjatë harkut kohor 2010-2014. Daljet nga **toka** zënë 75,3 %. Qarku i **Gjirokastrës** është qarku me përqindjen më të lartë të daljeve nga toka 35,3 % të shtetasve shqiptarë.

TRANSPORTI


Autovetura për 1000 banorë sipas rajoneve



Numri i autoveturave në vitin 2010 ishte 101 autovetura për 1000 banorë, ndërkohë për vitin 2014 është 131 autovetura për 1000 banorë, ku qarku i Tiranës zë 37,6 % të numrit gjithsej të autoveturave.

LEJET E NDËRTIMIT

Lejet e miratuara për ndërtesa të reja sipas qarqeve, 2014



Kërkesa për leje ndërtimi për banesa dominon në krahasim me kërkesat për ndërtesa industriale, hotele, tregtare, etj.


Lejet e ndërtimit të miratuara për banesa në vitin 2014 zënë 72,6 % të numrit gjithsej të lejeve.

BUJQËSIA

- Sektori i bujqësisë është një ndër sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare.
- Niveli më i lartë i prodhimit të drithrave në Shqipëri arrihet në qarqet e zonave të ulëta dhe bregdetare që përfshijnë Qarkun e Fierit, Elbasanit dhe Durrësit.
- Niveli më i lartë i prodhimit të pemëve frutore arrihet në zonën jug-lindore të vendit, qarku Korçë, Durrësi, Berati dhe Fieri.
- Sasia më e lartë e prodhimit të ullirit në Shqipëri është e përqëndruar në zonat fushore dhe bregdetare me kushte klimatike mesdhetare.

BLEGTORIA

- Qarku i Shkodrës, Fierit, Tiranës, Elbasanit mbareshtrojnë me shume gjedhe.
- Zonat malore të qarkut të Vlorës, Gjirokastrës Korçës mbareshtrojnë me shume te imta.
- Derrat janë tradicionalisht në vite që mbareshtrohen me shume në Lezhë dhe në Shkodër.




ABF 2007,2009,2014

Kjo anketë synon të paraqesë strukturën e shpenzimeve për konsum të NJEF-ve në Shqipëri.


Kjo anketë është kryer në vitet 2006-2007, 2008-2009 dhe duke filluar nga viti 2014 ajo do të kryhet cdo vit pranë NJEF-ve.

Shpenzimet për konsum mesatar mujor për NjEF sipas qarqeve ndër vite




ABF 2014

SHPENZIMET MUJORE SIPAS QARQEVE DHE ARSIMIMIT TË KRYEFAMILJARIT




ABF 2014

SHPENZIMET MESATARE MUJORE PËR KONSUM SIPAS QARQEVE DHE MADHËSISË SË NJEF



ABF 2014

Raporti decileve 10/90 sipas qarqeve



Ju faleminderit për vëmendjen tuaj!